



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L – 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 18, si dhe në bazë të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet në Republikën e Kosovës, neni 64 paragrafi 66.7, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rishpallë këtë:

## K O N K U R S

### **1. KQZ-07/2014 Zyrtar i Lartë Komunal Zgjedhorë në: 1 zyrtar në Mitrovicën e Veriut, dhe 1 zyrtar në Zveçan**

**Departamenti:** Koordinimi në Teren

**Niveli i pagës:** Koeficienti 8

**Kontrata:** Sipas Ligjit të SHCK-së

**Gjysmë orari:** Jo

**I raporton:** Koordinatorit të Terenit

**Përgjegjësitë mbikëqyrëse:** Nuk ka

**Detyrat kryesore:**

1. Kryeson Komisionin Komunal Zgjedhor, në bashkëpunim të plotë me Sekretariatit e KQZ –së;
2. Mbikëqyrë dhe u cakton detyra anëtarëve të tjerë të KKZ –së;
3. Mbikëqyrë punën e trupave zgjedhore në nivel komunal;
4. Bën raporte për aktivitetet në periudhën zgjedhore dhe jo zgjedhore;
5. Koordinon aktivitetet në mes KKZ-së dhe Administratës Komunale;
6. Informon SKQZ-së lidhur me kërkesat e Kuvendit Komunal për zëvendësimet e këshilltarëve komunalë;
7. Ndihmon dhe këshillon subjektet politike dhe organizatat joqeveritare;
8. Kryen detyra të tjera kur i caktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë sipas ligjit.

**Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:**

1. Të ketë Diplomë Universitare;
2. Një (1) vit përvojë pune në administratë publike;
3. Integritet të lartë personal dhe profesional;
4. Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
5. Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
6. Njohuri të mira në programet kompjuterike të MS Office.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Personelit, dhoma nr. 27 , kati I-rë, Ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës , Rruga "Migjeni" 10000 Prishtinë. Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në numrin e tel: 038-200-23-557, prej orës 08:00 – 16:00, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org). Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vullën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurrioni si dhe dy formularët e fundit të vlerësimit nga institucioni ku keni punuar. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit në afat ligjor nga zyra e personelit. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. **Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor, prej datës: 26.08.2014 deri me datë 09.09.2014 në ora 16:00.** Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë femërore dhe mashkullore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.